

Isak SHERIFI

QËNDRIMI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NDAJ ZHVILLIMEVE NË KOSOVË 1989-1990*

Federata Jugosllave asnjëherë nuk ka qenë më e paorganizuar se në periudhën e viteve të '89-'90. Të bindur se vetëm pavarësia dhe vetëvendosja mund ta shpëtonte popullin shqiptar nga kataklizma që i kanosej, delegatët e Kuvendit të Kosovës, më 2 korrik 1990 e shpallin Pavarësinë. Pas këtij akti, organet e Punëve të Brendshme të Federatës Jugosllave do të marrin masa të dhunshme, të cilat do të shkaktojnë reagime të shumta në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm. Manifestimet për paqe dhe mëvetësi politike i paraprijnë ngjarje shumë të rënda për popullin shqiptar. Fushata e madhe për ndryshimin e kushtetutës së Kosovës, me çka do t'i merret definitivisht autonomia, do të merr epilogun e saj. Serbia, më 23 mars, të vitit 1989, e vuri Kosovën në shtetrrëthim ushtarak.

Zhvillimet politike në Kosovë 1989-1990

Ngjarjet dramatike të viteve 1989 dhe 1990 në Kosovë, të përcjella me greva, protesta dhe demonstrata në mbrojtje të autonomisë së Kosovës, që filluan me ngujimin e minatorëve të minierës Trepça, në grevën shtatëditore në thellësi të galerive të minierës, si dhe grevave të vazhdueshme të studentëve dhe popullit të Kosovës, ndikuan që në Kosovë të vijnë gazetarët e agjencive dhe gazetave më të fuqishme ndërkombëtare për pasqyrimin e

* Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor "Kosova 15 vjet pavarësi - sfidat dhe shtetformimi", organizuar në Prishtinë, më 15 shkurt 2023.

gjendjes dhe informimin sa më real të lexuesve të tyre se çfarë ishte duke ndodhur në të vërtetë në Kosovë. Ngjarjet në Kosovë, të ndërmarrura nga organet e Punëve të Brendshme të Federatës Jugosllave, shkaktuan reagime të shumta si në opinionin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Reagimet pozitive të institucioneve relevante botërore

Në tetor të vitit 1990, në Kosovë qëndroi delegacioni katëranëtarësh i Komitetit për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut, i Asociacionit të Odës së Avokatëve të Nju Jorkut (SHBA). Delegacioni i parë nga Warren P. Stern, në përbërje të Michael E. Galligan, Deborah J. Jacobs dhe Morris J. Panner u takuan me zyrtarët jugosllavë dhe serbë të asaj kohe, si dhe me avokatët e specializuar për të drejtat e njeriut dhe me shqiptarët që ishin viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut. Produkti final i këtij misioni ishte raporti voluminoz 80 faqesh “Krizë kosovare dhe të drejtat e njeriut në Jugosllavi”, i cili iu shpërnda opinionit ndërkombëtar, më 13 shkurt 1990.

Nga ky raport disapjesësh, ku është dhënë edhe historiku i Kosovës nga koha e Perandorisë Romake gjer në krijimin e Jugosllavisë, statusi i Kosovës përbrenda Jugosllavisë, fillet e krizës dhe situata aktuale, në disa vazhdimë japin në mënyrë integrale pjesën që ka të bëjë drejtpërdrejt me shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Gazeta “Die Press” shkroi se: “Qeveria serbe dhe opozita janë unike në aksionin e tashëm dhe po bëjnë gara sa i përket ashpërsisë ndaj shqiptarëve të Kosovës. Pas gjendjes më të re të krijuar në Kosovë, me rastin e suspendimit të Kuvendit të Kosovës nga ana e Serbisë, FKADNJ (Fondacioni Kongresial Amerikan për të Drejtat e Njeriut) i bëri këtë apel administratës së Xhorxh Bushit, në lidhje me veprimet e fundit nga ana e qeverisë serbe, të cilët po sforconin konfrontimin mes shqiptarëve etnikë në Krahinën e Kosovës në Jugosllavi dhe forcave serbe, që e kontrollonin këtë rajon. Anëtarët e Fondacionit Kongresial për të Drejtat e Njeriut i bëjnë apel administratës së Bushit që të shprehë shqetësimin e madh se aktet armiqësore që ka ndërmarrë qeveria Serbe mund të çojnë në shkatërrimin e Jugosllavisë. Anëtarët e Kongresit bëjnë thirrje për një rishqyrtim të politikës amerikane ndaj Jugosllavisë duke futur kriterin e të drejtave të njeriut në përcaktimin e politikës amerikane. Anëtarët e Kongresit gjithashtu do të shprehin shqetësimin e tyre se me shthurjen e

Jugosllavisë do të destabilizohet rajoni i Ballkanit dhe do të çojë drejt konflikteve etnike.

Evoluime pozitive të mekanizmave ndërkombëtarë

Në Konferencën për dimensionin njerëzor të KSBE-së, të mbajtur në Kopenhagë në qershor të vitit 1990, shefi i delegacionit amerikan, Maks Kampelman tha se: “brenjos dhuna në Jugosllavi” dhe e këshilloi qeverinë e Jugosllavisë se problemet e Kosovës nuk do të zgjidhen pa dialog me organizatat demokratike shqiptare. Stejt Departamenti amerikan, më 30 qershor pasi shpreh shqetësimin për gjendjen e rëndë të krijuar dhe tensionet në Kosovë, konstaton se zgjedhja nuk mund të bëhet me kërcënime.

Senatori amerikan, Lary Presler, pasi dëgjoi për shpalljen e Kosovës subjekt të pavarur dhe demokratik, i shkroi një letër Sekretarit Amerikan të Shtetit, Xhejms Bejker dhe kërkoi që Qeveria amerikane të gjejë mënyrën dhe t’i japë përkrahje aktit të Pavarësisë dhe lëvizjes së fuqishme demokratike në Kosovë, si dhe mundësinë që qytetarët e Kosovës të vetëqeverisin. Rezoluta e parë që u paraqit para Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan është Rezoluta e nëntorit 1990, e sponsoruar nga senatori Alfonso d’Amato dhe kongresisti Lary Presler.

Kjo rezolutë në një mënyrë “ndërpret kontinuitetin” e “trembëdhjetë rezolutave të para” (1986-1991), sa i përket njohjes së mëtejme të RSFJ-së. Rezoluta D’Amato-Presler shtron qasjen e re ndaj hapësirës së ish-Jugosllavisë. Në Rezolutën për Kosovën, në pesë pika janë saktësuar konkluzionet kongresiane për gjendjen në Kosovë. Së pari shprehet mirënjohje ndaj shqiptarëve për durimin në këtë periudhë të vështirë, po ashtu përshëndetet edhe vendosmëria e tyre për zgjedhjen e problemeve në mënyrë paqësore dhe demokratike. Së dyti kërkohet nga qeveria e RS të Serbisë të inkuadrohet në dialogun paqësor dhe demokratik me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Kosovë duke përfshirë edhe LDK-në. Qeveria e Beogradit ftohet të ndërpresë dhunën, frikësimet, kërcënimet dhe përdorimin e forcës. Së treti, thuhet në Rezolutë se “kryetari i Serbisë (Millosheviqi) duhet të heqë dorë nga politika e tij shkatërrimtare”. Në rezolutë, Millosheviqi haptazi fajësohet për “rrënimin e kushteve për zgjedhje paqësore e demokratike në Kosovë, me të cilat do të respektoheshin të drejtat e të gjithë

qytetarëve”. Së katërti, ftohet “qeveria jugosllave dhe ajo serbe të sigurojë status të plotë autonom për krahinën e Kosovës dhe të rivendosë legjitimitetin e qeverisë në Kosovë”. Së pesti, “kryetari amerikan kërkohet që nga niveli më i lartë i qeverisë jugosllave t’i shprehë brengosjen e Kongresit për shkak të situatës në krahinën e Kosovës”. Në vitin 1992, para Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan u paraqit vetëm një projektrezolutë e veçantë për Kosovën, kjo ishte Rezoluta 21 e sponsoruar nga kongresmeni Tom Lantos. Kërkesa e kësaj Rezolute ishte “Njohja e Republikës së Kosovës nga ana e presidentit të SHBA-së”. Kërkesa për “njohjen e Republikës së Kosovës” arsyetohej me faktin se Kosova është përcaktuar si sovran në Konferencën e parë nacionalçlirimtare, e mbajtur më 1 janar të vitit 1944, si dhe me kushtetutat e RSFJ-së të vitit 1946 dhe të vitit 1974, si njëri nga konstituentët e Federatës Jugosllave. Serbia e shkatërroi autonominë më 23 mars të vitit 1989, pa pëlqimin e popullit të Kosovës, ndërsa Kuvendi i Kosovës më 2 korrik të vitit 1990, proklamoi Republikën e Kosovës dhe aprovoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës më 7 shtator të vitit 1990 duke u bazuar në parimin e vetëvendosjes, barazisë dhe sovranitetit. Kjo rezolutë kërkonte garantimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, sipas standardeve ndërkombëtare dhe mbështetej në parimin se të gjithë popujt kanë të drejtën që plotësisht të lirë të vendosin për statusin e tyre politik të brendshëm e të jashtëm.

Konkretizimi i trysnisë ndërkombëtare mbi hegjemoninë serbe

Më 27 maj 1990, në Prishtinë, një grup kongresistësh amerikanë si Tom Lantos, Joseph Dio Guardi u takuan me Ibrahim Rugovën dhe anëtarë të tjerë të kësaj partie, turma të mëdha njerëzish i prisnin, por edhe këtu policia i shpërndau me dhunë. Gjatë një interviste të dhënë për të përditshmen “Rilindja”, kongresisti amerikan Tom Lantos tha: “Do të interesohemi deri në fund për Kosovën”. Kjo vizitë e kongresistëve amerikanë u cilësua nga Beogradi si një cenim i sovranitetit të Jugosllavisë dhe Serbisë. Një vizitë tjetër e senatorëve amerikanë, e cila do të nxjerrë në pah qëllimin gjakatar të Beogradit dhe regjimin e Millosheviqit, do të jetë vizita e senatorit Robert Bob Dole. Senatorin e prisnin një turmë e madhe e njerëzve, të cilët gjenin një lloj mbështetjeje tek amerikanët, por edhe kjo turmë u keqtrajtua nga ana

e policëve serbë. Në këtë rast u lënduan rënd shumë pjesëmarrës dhe më pas u burgosën edhe shumë prej tyre me procedura të shpejta gjyqimi. Senatorët i këshilluan dhe ua tërhoqën vërejtjen liderëve shqiptarë që të jenë më të kujdesshëm dhe t'i shmangen çdo provokacioni të serbëve.

Parlamenti Evropian në Strasburg, më 13 korrik 1990, miratoi një rezolutë me të cilën dënon shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës kontrollin e pushtetit të Serbisë mbi mjetet e informimit në gjuhën shqipe dhe kërkoi pezullimin e menjëhershëm të masave të jashtëzakonshme në Kosovë. Parlamentarët evropianë kërkuan që të respektohet kushtetuta e vitit 1974, kurse Dhoma e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan miraton Rezolutën për Kosovën, me të cilën i bëhet thirrje Qeverisë së Kosovës që të ndalë dhunën, frikësimin dhe përdorimin e forcës si dhe të zgjidhë krizën politike dhe ekonomike në Krahinë, lirimin e të burgosurve politikë. Që nga viti 1981, vendos ta dërgojë në Kosovë delegacion duke kërkuar nga autoritetet jugosllave që të sigurojnë qarkullim të lire, autorizon kryetarin e vet që këtë rezolutë t'ia përcjellë Komisionit të Këshillit dhe të Ministrave të Parlamentit të Evropës dhe Qeverisë jugosllave e serbe. Kërkon njohjen e legjitimitetit të parlamentit të shpërndarë nga Serbia, rifillimin e punës së gazetave të ndaluara dhe hapjen e Radio Televizionit të Prishtinës, duke respektuar kështu të drejtën në liri të të shprehurit dhe të shtypit.

Raporti i Kenet Andersonit mbi të drejtat e njeriut në Kosovë

Misioni i përbashkët i US Helsinki Watch nga Nju Jorku dhe ai i Federatës Ndërkombëtare i të Drejtave të Njeriut të Helsinkit (IHF) nga Vjena do të qëndrojë në Kosovë në shtatorin e vitit 1989. Anëtari i Misionit, Kenet Anderson më pas do të përpilojë një raport të gjerë në lidhje me të drejtat e njeriut në Jugosllavi. Anderson në raportin i cili i kushtohet gjendjes në Kosovë, paraqet gjendjen faktike e cila mbretëronte në Kosovë. Në vazhdim do të paraqes disa nga pjesët më të rëndësishme të raportit: Qeveria serbe dhe jugosllave, kanë marrë masa shumë të forta të sigurisë, kundër shqiptarëve etnikë të Kosovës, kështu që, më 24 janar 1990, policia speciale dhe ushtria e shpartalluan me topa uji dhe gaz lotsjellës protestën në Prishtinë - kryeqytet i Kosovës. Në trazirat gjatë vikendit më 27-28 janar 1990, forcat jugosllave të sigurimit, vranë disa shqiptarë etnikë. Qeveria serbe dhe jugosllave kanë

konstatuar se masat e tilla janë të domosdoshme për mbrojtjen e pakicave joetnike shqiptare, që jetojnë në Kosovë, së pari të serbëve dhe malazezve dhe të grupeve të tjera minoritare, të cilat përbëjnë më pak se 15% të popullsisë kosovare. Mbrojtja e pakicave në Kosovë është kryesisht një pretekst, i cili i ofrohet bashkësisë botërore. Dyshimi i këtillë për keqpërdorim thellohet, kur si në rastin e Kosovës, pushteti shtetëror - ku qeveria serbe në bashkëpunim me qeverinë federale - përfaqëson vetëm njërën anë etnike të konfliktit. Sido që të jetë, mbrojtja e të drejtave të njeriut, nuk mund të zbatohet me anë të shkeljes sistematike të drejtave të të tjerëve, siç veprojnë tash për tash organet jugosllave me spastrime masive të shqiptarëve etnikë në Kosovë.

Kriza momentale në Kosovë i ka rrënjët në ndërrimet e kushtetutave të Kosovës, të Republikës së Serbisë dhe të Federatës Jugosllave, të cilat janë bërë në marsin e vitit 1989. Ato ndërrime kushtetuese e fshinë statusin autonom, që e kishte Kosova prej vitit 1974 dhe këtë rajon e bënë përsëri të varur nga Serbia. Shqiptarët etnikë janë popullsi shumicë në Kosovë. Në raport po ashtu do të paraqiten edhe keqpërdorimet e të drejtave të njeriut që qeveria serbe dhe ajo federative ka ushtruar gjatë ndërrimit të statusit të Kosovës si dhe izolimin dhe diferencimin që i bëhej popullit të Kosovës në këtë periudhë.

Reflektim i shkurtër

Periudha e viteve 1989-1990, respektivisht ngjarjet politike që përshkuan atë periudhë në Kosovë dhe më gjerë në Jugosllavinë e atëhershme, janë pasqyruar gjithandej në masmediat botërore të kohës. E rëndësishme mbeti se, shumica syresh kanë raportuar objektivisht dhe me largpamësi duke vënë nën thjerrëz rrezikun, që vinte nga shtypja dhe shembja e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës dhe jo vetëm të shqiptarëve të Kosovë, por edhe më gjerë. Vitet që do të pasonin më vonë, rrjedhat politike, ashtu siç do të zhvilloheshin, do t'u japin të drejtë të gjithë atyre masmediave dhe institucioneve ndërkombëtare, që dolën konkretisht kundër regjimit hegjemonist dhe të egër të kohës i instaluar forcërisht dhe në mënyrë jodemokratike nën kupolën politike dhe ushtarake të ish-Jugosllavisë, pa asnjë mëdyshje Serbisë së pas shkatërrimit të Jugosllavisë.